



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Arsimit  
Odeljenje za Obrazovanje



Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education

IV. Nr. l prot. 1062 Më 17.01 20 22  
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 84 dhe 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, neni 5, neni 14 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 të datës 28.04.2017, Drejtoria për Arsimit në Komunën e Rahovecit shpall:

## Konkurs

### Për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021/2022

1. Bursat ndahen për vitin akademik 2021/2022 për shkollimin universitar.
2. Numri i bursave të planifikuara është 100 ( njëqind ) bursa ;
3. Lartësia e bursës është 50 Euro ( pesëdhjetë euro) për muaj, për gjithsej 9 (nëntë) muaj;
4. Lartësia e bursës është 60 Euro (gjashtëdhjetë euro) për studentë që kanë notën mesatare mbi 9 (nëntë), për gjithsej 9 (nëntë) muaj.

### Kriteret për ndarjen e Bursave:

#### Për ndarjen e bursave do të aplikohen këto kritere:

- Lëmia e studimit;
- Suksesi gjatë studimeve (Nota Mesatare);
- Gjendja ekonomike familjare;
- Fëmijë të të rënëve në luftë.

### Kohëzgjatja e akordimit (dhënies së bursës):

- Bursa akordohet me kohëzgjatje prej 1 (një) viti akademik me të drejtë vazhdimi, nëse përfituesi i bursës ka regjistruar me sukses vitin pasues .

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim për bursë:**

- Kërkesa me biografi të shkurtër ;
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet lëmia e studimit (Fakulteti i cili regjistrohet) ;
- Çertifikata e notave;
- Fotokopja e indexit ose ID- kartelës ;
- Dëshmia mbi gjendjen sociale;
- Vërtetimin me të cilin vërtetohet përkatësia e familjes së të rënit në luftë;
- Kopjen e letënjoftimit.

### **Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët e regjistruar në Universitetet Publike.**

#### **Kohëzgjatja e konkursit:**

- Afati i konkurimit është 20 ditë pune nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Dokumentet dorëzohen në zyrat e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit.
- Afati i fundit për aplikim është data 11.02.2022 deri në ora 16:00.

**Rahovec,  
17.01.2022**

**Avni Morina**

**Drejtor**

